



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 01 mars 2016

Numri i lëndës: 2015-13

W.D.

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 shkurt 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me 14 dhjetor 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbliidhen si në vijim.
3. Në fund të gushtit të vitit 2012, në EULEX ankuesi e ka raportuar S.H., i cili ishte përshkruar si “*shef i grupit të Kuvendit të LDK-së*”.
4. Është supozuar se S.H. i kishte kërkuar ankuesit rryshfet (një makinë apo 30.000 euro) për ta ndryshuar përdorimin e tokës së ankuesit nga një toka bujqësore në një tokë për ndërtim. Ankuesi nuk pranoi të paguante. Si rezultat i kësaj, ai tha se ishte sulmuar.
5. Ankuesi raportoi çështjen në policinë e EULEX-it dhe deklaroi se atij i ishte ofruar mbrojtje nga EULEX-i. Ai tha se hetuesit i vendosën përgjues përderisa ai vazhdonte të merrej me të dyshuarin përderisa bëhej sikur ishte pjesë e planit të supozuar të S.H. dhe bashkëpunëtorëve të tij: A.A. dhe M.R. Ankuesi tha se e mori një makinë dhe u takua me S.H., A.A. dhe M.R. me 5 shtator 2012. Incizimi i bisedës u dërgua më pas në Zyrën për Përkthim të EULEX-it rreth orës 14:30 në të njëjtën datë. Në orën 15:30, brenda një ore pasi kasetat inkriminuese u dërguan në Zyrën për Përkthim të EULEX-it, S.H. thuhet ta ketë telefonuar A.A., i shqetësuar duke thënë se nuk dëshironte ta blente makinën. Ankuesi nga kjo konkludon se incizimi kishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it.
6. Është pohuar se S.H., A.A. dhe M.R. po hetoheshin të gjithë për korrupsion, por akuza ishte ngritur vetëm ndaj A.A. dhe M.R.

III. ANKESAT

7. Ankuesi pohon shkelje të dispozitave të mëposhtme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut (Konventa): nenet 3, 6 dhe 8 të Konventës.
8. Në veçanti, ankuesi pohon se përmbajtja e bisedës së përgjuar kishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it duke e vënë në rrezik sigurinë e tij.
9. Ankuesi gjithashtu pretendon se përkthimi që i është bërë bisedës së incizuar nuk pasqyron me saktësi shqetësimin e S.H. Si rezultat, ai thotë se prokurori holandez ka hedhur poshtë lëndën ndaj S.H. në bazë të një përkthimi jo të duhur. Lënda ishte bartur më pas te një prokuror italian, i cili refuzoi edhe më tutje ta merrte parasysh lëndën e S. H.-së mbi bazën se tashmë ishte ngritur një aktakuza.
10. Ankuesi gjithashtu pretendon se prokurori italian ishte i vrazhdë, i pasjellshëm dhe nuk dëgjoj asnjë përshkrim nga ai se incizimi që kishte rrjedhur duhej të hetohej.

11. Ankuesi pohon se askush në EULEX nuk ka treguar ndonjë shqetësim për të dhe për efektin e rrjedhjes së informatës që kishte në jetën dhe familjen e tij.
12. Si rezultat i kësaj, ankuesi thotë se ai dhe familja e tij janë lënë në një pozitë tejet të cenueshme. Ankuesi pohon se prokurori i EULEX-it ka dështuar të merrej me rastin dhe vetëm se ia kishin bartur lëndën një prokurori vendor. Qe dy vjet prej se është ngritur aktakuza, lënda asnjëherë nuk është gjykuar.
13. Ankuesi thekson se të drejtat e tij sipas neneve 3, 6 dhe 8 të garantuara sipas Konventës janë shkelur nga EULEX-i.

IV. LIGJI

14. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
15. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
16. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
17. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve apo të policisë së EULEX-it të marra lidhur me hetimet penale janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull, Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013, në par. 32; W kundër EULEX-it, 2011-07, 5 tetor 2012 në par. 21; Hoxha kundër EULEX-it, 2011-18, 23 nëntor 2011 në par. 22; Sllobodan Martinovic kundër EULEX-it, 2011-11, 23 nëntor 2011, par. 16).
18. Paneli më tej ka konstatuar se veprimet ose mosveprimet nga prokurorët gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk mund të konsiderohen se janë bërë në kuadër të “procedurave gjyqësore” (shih Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011 par. 64). Në lidhje me këtë, Paneli ka konstatuar se “veprimet dhe mosveprimet e

prokurorëve të EULEX-it [...] para ngritjes së aktakuzës mund të hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih Z kundër EULEX-it, 2012-06, 10 prill 2013, në par. 33; Thaqi kundër EULEX-it, 2010-02, 14 shtator 2011, par 93).

19. Rasti i tanishëm ka të bëjë me veprimet/mosveprimet e supozuara të prokurorëve të EULEX-it gjatë fazës hetimore. Pas shqyrtimit të ankesës për veprim/mosveprim, Paneli është i mendimit se ankesa në parim hyn në kuadër të juridiksionit të tij.
20. Paneli thekson se ankuesi së pari pohon se përmbajtja e bisedës së përgjuar kishte rrjedhur nga Zyra për Përkthim e EULEX-it. Pasi ka shqyrtuar dëshmitë e dhëna nga ankuesi, Paneli ka konkluduar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të pranuar se biseda e incizuar kishte rrjedhur dhe se çfarëdo rrjedhje ishte prej EULEX-it.
21. Pas shqyrtimit të materialit dhe informacionit të dhënë nga ankuesi, Paneli nuk është bindur se ai ka vërtetuar sugjerimin se çfarëdo veprimi dhe/ose mosveprimi që i atribuohet EULEX-it nga ai ka përbërë apo ka përfshirë shkelje të të drejtave të tij themelore. Prandaj, Paneli i konsideron këto pretendime qartas të pabazuara.
22. Lidhur me aspektet e tjera të ankesës, Paneli nuk është i bindur se akuzat janë vërtetuar në mënyrë adekuate nga ankuesi ose, aty ku janë, se përbëjnë shkelje të të drejtave të tij themelore. Prandaj, këto aspekte të ankesës janë qartas të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

Shpall se ankesa qartas është e pabazuar sa i përket rregullës 29 1. (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese